



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

PER/TO/ZA:	Kuvendi e Komunës Kryesuesin e Kuvendit, z. Fatmir Gashi
NGA/FROM/OD:	Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik z. Pajtim Balaj
CC:	z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJECT:	Raporti i Diskutimit Publik i Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që Operojnë në Teritorin e Komunës së Podujevës.
REFERENC/E:	Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr 01-300/01-0022481-21 i datës 10 mars 2021
DATE/A:	20 maj 2021

Te ndëruarra

Duke ju referuar vendimit të lartë cekur dhe me qëllim të zbatimit të tij ne kemi mbajtur më datë 22 mars 2021 takimim me qytetarë dhe përfaqësues të bizneseve në sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 10.
Në takim kanë qenë prezent 30 qytetarë/përfaqësues të bizneseve, mediat, përfaqësuesit e KFOR-it, etj. Takimin e shpalli të hapur drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik z. Pajtim Balaj, i cili në vazhdim i njëjti të pranishmit për nevojën e ndryshimit dhe plotësimin të Rregullores në fjalë. Pastaj e shpalli të hapur debatin.
Debatuan 19 qytetarë dhe kërkesat dhe propozimet e tyre ishin të fokusuar në nënim 6 të Rregullores gjegjësisht në pjesën e punës apo jo ditën e diel për subjektet tregtare ushqimore. Propozimet thuhje ishin të barabarta pro dhe kundra punës ditën e diel. Bizneset e vogla u ankuan se janë të rrezikuar nga bizneset e mëdha dhe rrezikojnë mbylljen e tyre nëse nuk ju ipet një mundësi për rikuperim bile ditën e diel. Gjithashtu pati propozime që bizneset të lejohen të punojnë ditën e diel në dy zonat e Komunës, në zonën e Liqenit të Batllavës dhe zona veriore mbij Kërpimëh. Nga farmacist pati një propozim që të reduktohen festat zyrtare në Viti i ri, 17 shkurti, Fiter Bajrami dhe Kurban Bajrami, ndërsa për festat tjera të punohet. Gjithashtu pati një

kërkes nga flokëtarët që ditën e shtunë të punohet deri në ora 22.00 pasi shumë klient të tyre nuk po mund të marrin shërbimin pasi janë në obligime pune dhe ditën e diel flokëtarët nuk punojnë. Duhet kyqur në Rregullorë orarin e punës së bizneseve veterinerë pasi nuk kanë qenë të përfshira deri tani. Orari i punës duhet të parashihet specifikat dhe nevojat për shërbime veterinerë. Bizneset e bizluterive, kozmetikës të trajtohen me orar të përbashkët dhe tu lejohet puna ditën e dielë për shkakë të specifikës së tyre. Të inkorporohen, pishinat dhe bizneset e tizingut pasi është në pritje numri i tyre. I dhe nga barnatoret bujqësore pati kërkesë për punë ditën e dielë pasi po kanë shumë kërkesa nga qytetarët dhe fermerët.

Në vijim po japim propozimet dhe rekomandimet sipas radhës :

- Omer Kosumi -Shoqëria civile, tha se duhet të kihet parasysh pozita e punëtorëve, dhe propozoj të mbetet në fuqi Rregullorja e vjetër.
- Muhamet Hasani, (tregti ushqimor) Kërkojë që të na lejohet puna ditën e dielë pasi kemi humbje si biznes i vogël ushqimor.
- Enver Kadriut (tregti ushqimor) kërkojë që të punohet ditën e dielë pasi si dyqan ushqimor ka punë të situar këtë ditë.
- Ramadan Mustafa (tregti ushqimor, farmaci) - Tha se vendimi për ditën e dielë ka qenë politikë dhe gabim dhe kërkoj që dita e dielë të jetë ditë pune.
- Ismaji Hasan (tregti ushqimor), propozoj të vazhdohet me rregullorën e vjetër sipas së cilës dita e dielë është ditë pushimi.
- Sabri Rushiti (tregti ushqimor), Propozoj që të vazhdohet me orarin e vjetër.
- Sabedin Buzati (tregti ushqimor), propozoi që me përjashtim të Zonës së Orllanit, dita e dielë të mbetet ditë pushimi.
- Amer Krasniqi (tregti ushqimor), propozoj të vazhdohet me orarin e vjetër.
- Regjep Zeka, në emër të bizneseve të zonës së Orllanit, tha se i ka dëmtuar rregullorja e vjetër dhe kërkuar ndryshimin e saj, ku kjo zonë të trajtohet si duhet dhe tu lejohet puna gjatë gjithë vitit edhe ditën e dielë.
- Ekrem Ljalloshiti (tregti ushqimor), propozoj që të vazhdohet me orarin e vjetër..
- Meriton Hyseni, barnatore bujqësore, të lejohet puna e barnatoreve bujqësore ditën e dielë pasi ka shumë kërkesa nga qytetarët.
- Gazmend Miftari (tregti ushqimor), propozoj të vazhdohet me orarin e vjetër të punës, sipas të cilit dita e dielë është pushim, kurse për Orllanin dhe Kerpimchin të gjendet një zgjedhje e mirë.
- Bekim Jashari, servis i automjeteve, tha se kërkoj të punohet ditën e dielë sepse po dëmtohemi dhe po i humbasim myshterinjët.
- Mentor Jaha, propozoj reduktimin e festave zyrtare si ditë pushimi dhe atë : 1 janar, 17 shkurt, Fitër bajram dhe Kurban bajram, dhe dita e dielë të mbetet ditë jo pune.
- Avni Dardani, frizer, propozoj ndryshimin e rregullores pasi tha se orari i vjetër na ka dëmtue, dhe kërkoj që dita e dielë të jetë ditë pune.
- Liridon Havoll, frizer (ETC) the se jemi të dëmtuar dhe kërkoj që të punohet me orar të zgjatur gjatë javës. Propozoj deri në 10.30 ditën e shtunë.

Në ora 11.45 drejtori Balaj e shpalli të mbyllur diskutimin publik pas nuk pati më kërkesa për propozime nga të pranishmit.
 Gjithashtu bazuar në vendimin e lartë cekur qytetarët/bizneset kanë mundur që propozimet, rekomandimet apo vrejjet eventuale ti përcjellin përmes postës elektronike (kanë qenë dy adresa në dispozicion). Gjithsej kanë arritur 13 kërkesa me propozime dhe rekomandime rreth orarit të punës së bizneseve.
 - Pronarët e dyqaneve ushqimore nga Orllani, përfaqësuar nga Rexhep Zeka, propozojnë që dita e dielë të jetë ditë pune nga 07.00-22.00.
 - 5 kërkesa janë që të mos ndryshohet neni i rregullores aktuale dhe dita e dielë të mbetet ditë pushimi.
 - 3 kërkesa nga bizneset e frizerëve që kërkojnë që e diela të jetë ditë pune si dhe të zgjatet orari ditëve të tjera deri në ora 22.00.
 - 5 kërkesa janë për lejmimin e punës ditën e diel për bizneset tregtare ushqimore.

PËRMBLEDHJE E PROPOZIMEVE

Nga sa u tha më lartë ne kemi përmbledhur propozimet të cilat shprejnë se janë të arsyeshme, të nevojshme dhe me interes për qytetarët dhe bizneset e komunës sonë. Në vijim po i japim propozimet që duhet inkorporuar në draftin e rregullores që do të jetë shtojcë e këtij raporti.

- Tu mundësohet puna ditën e diel për barnatorët bujqësorë, ngase shumica e aktivitetëve bujqësorë zhvillohen ditën e diel dhe ka nevojë për furnizime.
- Për ta mbajtur zingjirin e furnizimit me gjëra ushqimore dhe për ti fuqizuar sado pak bizneset e vogël tregtare të artikujve ushqimorë, tu mundësohet puna ditën e diel bizneseve me hapësirë më të vogël se 80 m², nga ora 07.00-22.00 në periudhën dimërore dhe nga ora 07.00-23.00 në periudhën verore.
- Të zgjatet orari i punës për Qendrat Tregtare, Supermarketet dhe dyqanet e mëdha tregtare ushqimore në periudhën verore nga ora 07.00-23.00
- Të reduktohen festat zyrtare si ditë pushimi në: 01 janar, 17 shkurt, Fitër Bajram dhe Kurban Bajram, kurse festat tjera zyrtare të jenë ditë pune.
- Të inkorporohet në draftin e rregullores orari i punës për bizneset veterinerë pasi nuk kanë qenë të përfshirë në rregullorën aktuale.
- Të inkorporohen bizneset tregtare të kozmetikës pasi janë të shumta në numër dhe të jenë në një orar me bizneset tregtare të bizhuterisë dhe dekorimit.
- Të inkorporohen pishinat e hapura dhe të mbyllura.
- Të inkorporohen bizneset e dhënjes me qera/lizimigut të automjeteve.

Këto propozime do të inkorporohen në Draftin e Propozim Rregullores për Orarin e Punës për Bizneset që Operojnë në Teritorin e Komunës së Podujevës.

Shtojcë:
Propozim Rregullorju e Orarit të Punës së Bizneseve që Operojnë në Teritorin e Komunës së Podujevës.